



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

RAPORTI TEKNIK


Objekti :

*"Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, L=800 ml ,
b=4m+0.5 bankine"*

PROJEKT ZBATIMI

Firma konsulente

A.SH. Engineering sh.p.k.



Adresa : Rr. Grigor Gjirokastriti , godina 29
Tirane – Shqiperi

Tel: 06920 80982

Email: ashengineer2000@gmail.com

* Prill 2024 *




PËRMBAJTJA E RELACIONIT

1. – TE PERGJITHSHME

- Hyrje
- Pozicioni i objektit
- Gjendja Ekzistuese
- Studimi Topografik

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- Trupi i Rruges
- Elementet Gjeometrike te Rruges
- Shtresat Rrugore
- Konkluzione



1. - TË PËRGJITHSHME

- HYRJE

Pas miratimit të ndarjes së re administrative-territoriale në vitin 2015 , Roskoveci mbajti statusin e “Bashkisë” si një nga 61 bashkitë e vendit tonë. Pozitiv është fakti se kjo bashki rifitoi territoret e saj duke përfshirë edhe fshatrat e ish-komunave Strum , Kuman e Kurjan. Qendra e Bashkisë është në Roskovec dhe ka në përbërje edhe 3 Njësi Administrative : Kuman, Kurjan dhe Strum.

Aktualisht përfshihen 14 fshatra, me një popullsi prej rreth 32 163 banorë, sipas regjistrimit të Gjendjes Civile. Roskoveci, njihet për terrenin kodrinor . Popullsia në këtë qytet kryesisht e siguron jetesën me prodhime bujqësore, blegtorale, agrumet dhe sera. Përmes këtij projekti synohet të realizohen koncepte të reja dhe sa më origjinale, për të ndryshuar imazhin e këtij vendi, i cili duhet të shërbejë në dobi të zonës.

Është e rëndësishme të kuptohet që koncepti është bazuar në kërkesat e zones, i përgjigjet nevojave të komunitetit, por njëkohësisht është informuar nga eksperiencia të sukseshme të vendeve të tjera.

Është kryer një diskutim i gjerë me publikun dhe aktorë të tjerë për të pasur një program sa më të gjerë gjatë projektimit dhe për të kuptuar se si ndikon rehabilitimi i një hapësire urbane në teresi

- POZICIONI I OBJEKTIT

Ky fshat ndodhet në Njësinë Administrative Strum , Strumi është një fshat i pozicionuar në jverilindje të qytetit të Roskovecit, i cili njihet për terrenin kodrinor .Fshati kufizohet në jug me fshatin Kurjan, në veri me fshatin Suk.



- GJENDJA EKZISTUESE

Rruga aktuale e fshatit s’është e asfaltuar në gjendje jo të mirë, ambjenti rreth saj është jo i zhvilluar duke dhënë një pamje të pakëndshme dhe të pa aksesueshme nga banorët e zonës.


Sistemimi i kesaj rruge do te krijoje lehtesimin e aksesit si per automjetet, edhe per kembesoret

Qëllimi kryesor i projektit është : “Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, L=800 ml , b=4m+0.5 bankine”

Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, do ti jap fund të gjithë problematikave të infrastrukturës urbane. I gjithë investimi ndikon terthorazi ne ekonomine lokale sepse burimi kryesor i te ardhurave te tyre eshte tregtimi i produkteve bujqesore dhe blegtorale. Tregtia permiresohet me lehtesimin e aksesit.



"Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, L=800 ml , b=4m+0.5 bankine"



- RAPORTI TOPOGRAFIK

Puna gjeodezike dhe topografike për Projekt-Preventivi i zbatimit të ndërtimit të rruges u bazua në kërkesat teknike të përgjithshme, të kërkesave specifike të parashtruara nga termat e referencës të renditura në detyrën e projektimit të investitorit me firmën projektuese, si dhe mbi bazën e përvojës së përfutur në punimet e mëparshme të kësaj natyre.

Njohja fillestare me detyrën topografike motivoi grupin e punës në përgatitjen e materialeve gjeodezike e cila fillon me sigurimin e hartave dhe të koordinatave të pikave mbështetëse gjeodezike për zonën ku shtrihet rruga, e cila shërbeu për përcaktimin e saktë të metodikës dhe organizimit të punës dhe për mënyrën e ndërtimit të rrjetit gjeodezik mbështetës. Me pas në terren se bashku me projektuesit, grupi topografik mori udhëzimet për gjurmën rruges duke patur parasysh kategorinë e saj, si dhe identifikimin e veprave të artit, azhurnimi i tyre si nga ana funksionale dhe pershtatja pozicionale sipas aksit të ri. Korigjimi i pjerresive duke patur parasysh permiresimin altimetrik në sinkron me pozicionin planimetrik të rruges ekzistuese me variantin e projektuesit.

Grupet në terren do të përbehen nga një Inxhinier ekspert Topograf, një teknik i mesëm topograf me eksperiencë në procesin e rievimit dhe 2 punëtor.

Pas grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm teknik dhe ligjor grupet e punës në terren filluan menjëherë nga puna duke bërë rikonzhucionin e rruges, duke u konsultuar me termat e referencës

Pas rikonzhucionit të zonës filloi materializimi i pikave mbështetëse gjeodezike i cili do të shërbejë për rievimin dhe azhurnimin e gjithë zonës.

Metoda për ndërtimin e këtij rrjeti gjeodezik do të bazohet mbi teknologjinë e fundit të shkencës dhe të elektronikës në fushën e gjeodezisë. Për këtë proces do të përdoret GPS Trimble 5800 me një precizion tepër të lartë në matje.

Përdorimi i instrumentave në fjalë bën të mundur kalimin e informacionit të marrë në terren direkt në kompjuter dhe krijimin pa vështirësi dhe tepër të sakte të hartave treguese.

Rievimi do të realizohet në këtë mënyrë:

Si fillim, që në momentin e parë të këtij studimi do të bëhet rikonzhucioni i zonës dhe do të vendoset për mënyrën e kryerjes së këtij procesi. Duke menduar që të dhënat topografike do të jenë sipas rrjetit koordinativ shtetëror, do të fillohet me grumbullimin e materialeve të nevojshme për transformimin e të dhënave tona në këtë rrjet. Kështu nga hartat 1:10 000 të zonës do të identifikohen pikat e triangolacionit Shqiptar dhe do të merren të dhënat nga Instituti Topografik Ushtarak për këto pika, si dhe listën e reperave dhe të markave në këtë zonë. Me pas do të zhvillohet një rrjet poligonal i mbështetur në këto pika dhe duke përdorur teknologjinë GPS. Me një GPS baze dhe tre recivitor GPS do të ndërtohet një rrjet trekëndëshash për të llogaritur koordinatat e pikave të poligonit në mënyrën më të saktë të mundur.

Llogaritja e pikave poligonale të matura me GPS do të bëhet duke përdorur si program "Trimble Geomatics Office", koordinatat WGS84 do të konvertohen në sistemin koordinativ UTM zona 34 North dhe do të bëhet lidhja me triangolacionin shqiptar. Pikat e rrjetit të poligonit do të ndërtohen jo më larg se 300m në mënyrë që të shohin njëra-tjetrën. Ato do të



pozicionohen ne vende te tilla qe te behet e mundur nje jetegjatesi sa me e madhe, ne menyre te tille qe ti sherbejne edhe fazes se ndertimit te vepres.

Te gjitha pikat e rilevuara ne terren do te jene te regjistruara me kode specifike ne memoriet e brendshme te instrumentave te perdorura nga ana jone. Pikat e regjistruara ne terren do te transferohen ne kompjuter me programet e realizuara perkatesisht per kete proces. Me vone te gjitha pikat do te perpunohen dhe fillon krijimi i hartes dixhitale ne shkalle reale ne kompjuter. Ne terren do te rilevohen te gjitha pikat karakteristike per te pozicionuar te gjitha detajet.

Rendesi te veçante do ti kushtohet pozicionimit te detajeve si: ndertimet e ndryshme civile, elementet e infrastruktures, (rrjeti elektrik, telefoni, ujesjelles) etj.

Programi qe do te perdoret do te jete “Autocad Map 2022” dhe do te jene te vizatuar te gjithe elementet planimetrik. Te dhenat finale do te jene “file” dwg si dhe nje Model i Terrenit ne forme dixhitale ne formatin DXF, per projektimin e rruges me programet perkatese.

Te gjitha pikat e matura do te jene te pranishme ne harten e krijuar. Izoipset do te krijohen nepermjet programit perkatese Sierra Geomatics Soft.

Përnjohja e terrenit, ndërtimi, matja dhe llogaritja e rrjetit gjeodezik

Gjatesia e rruges se piketuar eshte rreth 1450 ml.

Persa i perket gjeometrise se rruges ato jane karakteristike te nje rruge kodrinore malore, me gjeresi qe varion nga 4.0 m deri ne 5.0 m te pa shtruara, me taban relativisht te mire .

Duke u mbështetur në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, në seriozitetin dhe përgjegjësinë për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit, shprehim bindjen se punimet topogjeodezike plotësojnë të gjitha kërkesat teknike për projektimin e rrugës. Rrjeti gjeodezik në formën e poligonometrisë i ndërtuar në terren dhe katalogu i koordinatave dhe lartësive, që bashkëngjiten në këtë raport shërbejnë dhe për zbatimin e punimeve.

2. - ZGJIDHJA E PROJEKTIT


– TRUPI I RRUGES, BANKINAT, TROTUARET

Asfaltim I rruges se Priftanjakeve, fshati Strum në qytetin e Roskovecit , do ti jap fund të gjithë problematikave të infrastrukturës urbane. I gjithë investimi ndikon terthorazi ne ekonomine lokale sepse burimi kryesor i te ardhurave te tyre eshte tregtimi i produkteve bujqesore dhe blegtrale. Tregtia permiresohet me lehtesimin e aksesit.

Rruga do të kete keto parametra gjeometrike:



Gjeresi te trupit te rrugës 2x2.0m, e cila do perbehet prej pjesës së asfaltuar 2x2.0m dhe kuneta 2x0.5m nga dy anët dhe kanal djathtas.



Zgjidhja e Projektit sipas kushteve aktuale te terrenit, gjendjes ekzistuese te rrugeve si dhe perspektives se zhvillimit mund te pershkruset e si me poshte:
Bazuar ne KTP per rrugët ne fuqi, ne Nenin 2 te Kodit Rrugor jepen perkufizimet e rrugeve, klasifikimi dhe karakteristikat e tyre. Kodi Rrugor i Shqiperise paraqet klasifikimin e meposhtem ne lidhje me rrugët:

- A – Autostrade (Autorruges);
- B – Rrugët nderurbane paresore;
- C – Rrugët nderurbane dytesore;
- D – Rruges urbane paresore;
- E – Rruges urbane dytesore;
- **F – Rruges lokale rurale.**

Mbi bazen e ketij klasifikimi, Kodi Rrugor paraqet rregullat mbi funksionimin e institucioneve dhe organizmave respektive duke specifikuar pergjegjesitë e autoriteteve te ndryshme rrugore. Pra rruga jone perfshihet ne kategorine F, rruges lokale rurale.

– ELEMENTET GJEOMETRIKE TE RRUGES

Rrugë lokale Rurale

“Asfaltim I rruges Priftanjaket , fshati Strum, L=800 ml , b=4m+0.5 bankine”

Rrugë urbane ose ndërrurbane me nje karrexhatë me një korsi ose nje korsi per kah levizje dhe me bankinë të shtruar ose të pashtuar në secilin kah. Ajo siguron hyrje daljet ne pronat private urbane ose rurale dhe sherben si niveli fundor i rrjetit rrugor.duhet të vihet re se në rrethana të veçanta, karakteristikat e paraqitura në Tabelë mund të mos vlejné për disa rrugë rurale.

Rruga qe do te asfaltohet do të kete keto parametra gjeometrike: gjeresi te trupit te rrugës 4m me asphalt .
Gjurma kalon ne nje zone kodrinore gjysem shkembore.

– KONKLUZIONE

Nderhyrja ne zonen e parashikuar per asfaltimin e kesaj rruge me kete projekt duke zbatuar me rigorozitet detajet teknike dhe kushtet teknike te zbatimit garanton sigurine e vepres dhe ploteson detyren e projektimit me se miri.

Pergatiti

**Grupi I Projektimit
A.SH.Engineering sh.p.k**

